

# Astma

## **Gjatë vizitës së parë:**

- Kryeni vlerësimin klinik: merrni anamnezën dhe bëni një ekzaminim fizik të detajuar.
  - Përdorni Tabelën e probabilitetit dhe Algoritmin e diagnozës së astmës.
  - Matni dhe dokumentoni PEF.
- Referoni te specialisti për konfirmim diagnoze dhe trajtim fillestar.

## **Gjatë vizitës pas konsultës te specialisti:**

- Filloni trajtimin sipas rekomandimit të specialistit dhe vlerësimin të shkallës së rëndesës së astmës
- Kryeni vlerësimin e faktorëve shkaktarë, dokumentoni pyetësorin dhe bazuar në informacionin që merrni prej tij, gjykoni referimin tek specialisti për testet alergjike.
- Kryeni vlerësimin e faktorëve të riskut dhe sëmundjeve bashkëshoqëruese
- Edukoni pacientin rreth astmës dhe vetë-menaxhimit
  - a. Pacientit i jepet plani i veprimit për astmën
  - b. Mësojuni teknikën e përdorimit të inhalatorëve
- Planifikoni vizitën ndjekëse të radhës pas 2-6 javësh, duke monitoruar kontrollin për 1-6 muaj, dhe nëse parashikohet një hap prapa në terapi, monitoroni çdo 3 muaj.